

Në bazë të nenit 28, paragrafi 3 i Ligjit për koncesione dhe partneritetit publiko privat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/12, 144/14, 33/15, 104/15 dhe 215/15), neni 55 i Ligjit të Ujërave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 87/08, 6/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 23/13, 163/13,180/14 dhe 146/15) dhe Vendimi për fillimin e procedurës për ndarjen e koncesionit për shfrytëzimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike nga 37 hidrocentrale të vogla ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr 21/16), Komisioni për zbatimin e procedurës për ndarjen e koncesionit për shfrytëzimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike nga 37 hidrocentrale të vogla, shpall

THIRRJE PUBLIKE

Për mbledhjen e ofertave për ndarjen e koncesionit për shfrytëzimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike nga 37 hidrocentrale të vogla sipas modelit Projektimi, Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (DBOT- Design, Build, Operate, Transfer) i pelljeve të lumenjve: Vardar, Treska, Bregallnica, Strumica dhe Drini i Zi.

1. Koncedent është Qeveria e Republikës së Maqedonisë.
2. Lëndë e koncesionit është shfrytëzimi i ujit për prodhimin e energjisë elektrike nga 37 hidrocentrale të vogla në lokacionet në vijim:

Lokacionet e propozuara për HCV							
Numri rend.	Numri iden.	Rrjedha e ujit ose emri i elektranës	Pellgu	Koordinata		Rrjedha mesata re-vjetore (m ³ /s)	Fuqia e instaluar KW
				Kaptazhi			
				Y	X		
1.	80	I.Karanikollos	Pena	7487095	4657877	0,224	442
2.	81	I.Pena	Vardar	7481659	4652577	0,747	1908
				7482652	4654145		
				7482866	4654566		
				7483104	4655084		
				7483508	4655788		
				7484309	4656181		
				7484511	4656531		

3.	82	l.Pena	Vardar	7480545	4650876	0,255	858
	84	l.Pena	Vardar	7483464	4654843	1,25	1953
	85	l.Pena	Vardar	7489949	4655836	1,56	3093
	91	l.Sheliçë	Pena	7490344 7490869	4658082 4658131	0,28	1228
4	100	l.Leshoçkë	Vardar	7499958	4660560	0,153	300
	101	l.Leshoçkë	Vardar	7500902	4660056	0,227	557
5	164	l.Kadinë	Vardar	7548099	4631338	1,86	2260
6	167	l.Kadinë	Vardar	7551249	4631950	2,55	1148
7	53	l. Kozicë	Bërzhdansk ë	7493951 7493427	4585589 4586227	0,086	70
8	54	l. Judovskë	Bërzhdansk ë	7491531	4588805	0,084	80
9	365	l.Kratovskë	Kriva Reka	7599536	4661043	0,142	147
10	137	l.Otljanskë	l. i Likovës	7546151	4667705	0,128	239
11	302	l.Siravë	Strumica	7631136	4618455	0,136	263
12	303	l.Siravë	Strumica	7631574	4615511	0,186	338
13	305	l.Radovishkë	Strumica	7621045 7620640	4621282 4621179	0,139	373
14	394	l. Mramoreçkë	Sateskë	7489836 7489945	4581401 4580737	0,178	218
15	361	l.Malla Reka	Koçanskë	7616055	4649180	0,113	139
16	354	l.Crvulleskë	Bregallnicë	7615103	4628421	0,059	103
17	355	l. Crvulleskë	Bregallnicë	7613673	4629041	0,064	126
18	357	l.Kozjaçkë	Bregallnicë	7610692	4626777	0,201	346
19	358	l.Koxha Dere	Bregallnicë	7611407	4625735	0,219	387
20	356	l. Crvulleskë	Bregallnicë	7610715	4629493	0,102	180
			Bregallnicë	7609878	4628850		
21	323	l.Zameniçkë	Bregallnicë	7660671	4612433	0,118	189
				7659232	4613588		
22	364	l.Shtallkovsk ë	Ziletovskë	7606839	4650913	0,136	278
				7519508	4577987		
23	253	l.Oshtrillskë	Lumi i Zi	7520033	4578067	0,098	308
				7519508	4577987		
24	254	l.Zhaba	Lumi i Zi	7515874	4582693	0,366	380
25	255	l.Brezovskë	Lumi i Zi	7509440	4576666	0,135	224

26	245	l.Kamenë	Lumi i Zi Lumi i Zi	7585978 7584184	4576987 4577181	0,203	540
27	213	l.Bella Reka	Lumi i Zi	7561664	4545932	1,13	4360
28	214	l.Satoka	Lumi i Zi	7565119	4552795	0,319	645
29	216	l.Buturicë	Lumi i Zi	7564000	4559271	0,279	1135
30	227	l.Gradeshkë	Lumi i Zi	7569124	4547891	0,344	663
31	228	l.Gradeshkë	Lumi i Zi	7563310	4549360	0,497	1000
32	233	l.Bella Reka	Lumi i Zi	7569030	4543333	0,299	920
33	234	l.Bella Reka	Lumi i Zi	7565024	4544632	0,385	761

3. **Të drejtë për pjesëmarrje** në këtë thirrje publike kanë të gjithë personat juridik ose fizik vendas dhe të huaj ose konsorciumet nga subjektet e lartpërmendura, të cilat do të marrin dokumentacionin e tenderit dhe do t'i plotësojnë kushtet në pajtim me dokumentacionin e tenderit. Dokumentacioni i tenderit mund të merret në arkivin e Ministrisë së Mjedisit Jetësor çdo ditë pune. Dokumentacioni i tenderit përmban të dhëna hidrologjike, gjeologjike dhe topografike dhe të dhëna që kanë të bëjnë me pronësinë e tokës, si dhe kushtet që duhet të përmbushen nga koncesionari.

4. **Ofertuesit duhet të dorëzojnë dëshmi për aftësinë e tyre, duke përfshirë:**

- **Aftësi për kryerjen e aktiviteteve profesionale:**

- A) Për ofertuesit e brendshëm: Dokument për veprimtari të regjistruar (DRD formularë) të nxjerra nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë. B) Për ofertuesit e huaj, është e nevojshme që të dorëzohet dokument nga organi kompetent - vërtetim se gjindet në regjistrin tregtar zyrtarë që udhëhiqet nga organi kompetent i vendit ose vërtetim nga organi kompetent për certifikim që i plotëson kushtet e përcaktuara me ligj;

- **Gjendja ekonomike dhe financiare e ofertuesëve:**

- A) Për ofertuesit vendas dhe të huaj: raporti i bilancit të gjendjes të certifikuar nga organi kompetent, përkatësisht bilanci i reviduar i gjendjes për tre vitet e fundit fiskale ose ekstraktet nga raporti i bilancit të gjendjes, në rastet kur publikimi i bilancit të gjendjes përcaktohet me ligj në vendin kur operatori ekonomik është i regjistruar. Raporti i auditimit të përmbaj të dhëna për punën e përgjithshme ekonomike të ofertuesit për tri vitet e fundit fiskale (2013, 2014 dhe 2015). Nëse personi juridik është i regjistruar në periudhë më të shkurtër se ky, raportet financiare të dorëzohen për periudhën e regjistrimit;
- A) Për ofertuesit vendas dhe të huaj: certifikata e qarkullimit të përgjithshëm të ndërmarrjes (të dhënat nga bilanci i suksesit të

- dhënë nga organi kompetent, përkatësisht bilanci i reviduar i suksesit) edhe atë më së shumti për tre vitet e fundit financiare (2013, 2014 dhe 2015), për të cilat janë në dispozicion informacionet e tilla në varëshmëri nga data në të cilën ndërrmarja është themeluar ose ka filluar punën dhe në varëshmëri të disponueshmërisë së informacioneve të këtylla;
- Të ardhurat e përgjithshme të ofertuesëve, kumulative në tri vitet e fundit nuk duhet të jenë më pak se 500 euro për kW kapacitet të instaluar sipas ofertës në formë të plotësuar në mënyrë të rregullt të nënshkruar sipas ANEKSIT C: Letër e ofertës; Nëse personi juridik është i regjistruar në periudhë më të shkurtër se tre vite, dokumentet e nevojshme të dorëzohen për periudhën e regjistrimit përfundimisht me vitin e fundit fiskal. (Të ardhurat e përgjithshme për këto ofertues nuk duhet të jenë më pak se 500 euro për kW kapacitet të instaluar në periudhën nga regjistrimi i tij përfundimisht me vitin e fundit fiskal, sipas ofertës së saj në formë të plotësuar në mënyrë të rregullt të nënshkruar sipas ANEKSIT C: Letra e ofertës)
 - Statusi Personal:
 - A) Për personat vendas: Vërtetim i tatimeve të paguara, kontributeve dhe taksave tjera publike të lëshuara nga Drejtoria e të Ardhurave Publike të Republikës së Maqedonisë. B) Për personat e huaj: Vërtetim nga organi kompetent në vendin e origjinës për tatimet e paguara dhe taksat tjera publike;
 - A) Për personat vendas: Vërtetim se personi në fjalë nuk është në procedurë likuidimi i dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë. B) Për personat e huaj juridikë: Dokument nga organi kompetent në vendin e origjinës se personi në fjalë nuk është në procedurë falimentimi;
 - A) Për personat vendas: Vërtetim se personi në fjalë nuk është në procedurë likuidimi i dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë. B) Për personat e huaj: Dokumenti nga organi kompetent në vendin e origjinës se personi në fjalë nuk është në procedurë likuidimi;
 - deklaratë se personit në pesë vitet e fundit nuk i është shqiptuar vendimi i formës së prerë për pjesëmarrje në organizatën kriminale, korrupsionin, mashtrim ose pastrim parash.
 - dokument se ofertuesit nuk i është shqiptuar një dënim tjetër.

ndalesë për pjesëmarrje në procedurat për thirrje publike, ndarjen e kontratave për furnizim publik dhe kontratave për partneritetin publiko privat

- dokument se ofertuesit nuk i është shqiptuar një dënim tjetër ndalim i përkohshëm os ei përhershëm për kryerjen e veprimtarie të veçantë,
- vërtetim se personit nuk i është shqiptuar sanksion kundërvajtës, ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, përkatësisht ndalim të përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar.

Dokumentet për vërtetimin e statusit personal të ofertuesit nuk duhet të jenë më të vjetra se gjashtë muaj nga data e hapjes së ofertave, ndërsa dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuar nga ofertuesi.

- Deklarat e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e konsorciumit për paraqitje të përbashkët të tenderit, Në deklaratën anëtarët e konsorciumit duhet që të përcaktojnë anëtarë udhëheqës dhe në mënyrë të qartë ta emërojnë, si dhe ta shprehin pjesëmarjen procentuale kapitale të secilit anëtar të konsorciumit.

5. Oferta e përgjithshme duhet të jetë në gjuhën maqedonase. Dokumentacioni shoqërues i ofertës, që kërkohet në pajtim me dokumentacionin tenderial, duhet të jetë në origjinal ose kopje e vërtetuar nga noteri. Dokumentacioni nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj, përveç raporteve financiare.

6. Ofertuesit mund të japin oferta për një, ose më tepër lokacione për hidrocentrale të vogla, përkatësisht për një ose disa grupe të lokacioneve të hidrocentraleve të vogla, por jo më shumë se një ofertë për një lokacion, përkatësisht një grup lokacionesh. Personi juridik në të njëjtën kohë mund të jetë anëtarë vetëm i një konzorciumi i cili dorëzon ofertë për të njëjtin lokacion /grup lokacionesh. Procedura për ndarjen e koncesionit do të zbatohet për secilin lokacion në veçanti. Numri i nevojshëm minimal i ofertuesve të aftë të cilët mund të parashetrojnë ofertat për një lokacion është një.

7. Oferta duhet të përmbajë:

- letrën e ofertës;
- dëshmi të përmendura në pikën 4.2 të kësaj shpalljeje,
- rishikimin e vendimit të objekteve të bazës topografike

- dhe gjeodezike,
- të dhënat për rrjedhat karakteristike (rrjedhat minimale, mesatare mujore), për profilin e kaptazhit të ujit për periudhën e të paktën dhjetë viteve,
 - sasinë e ujit që planifikohet të grumbullohet dhe mënyra e grumbullimit,
 - mënyrën e shkarkimit të ujërave,
 - karakteristikat themelore të objektit me të cilin kryhet veprimtaria, dhe
 - deklaratën e nënshkruar nga anëtarët e konsorciumit për pjesëmarrjen e përbashkët në procedurën për ndarjen e koncesionit të ujit në të cilin qartë do të emrohet anëtari udhëheqës dhe përqindja e pjesëmarrjes kapitale të secilit anëtarë të konsorciumit.
 - Garancinë për pjesëmarrjen në procedurë

8. Personi i cili e merr dokumentacionin e tenderit duhet të dorëzojë autorizimin e firmës për të cilën e merrë dokumentacionin dhe në këtë autorizim duhet të ceken të gjitha të dhënat e nevojshme për kontakt (adresa, telefoni, faksi dhe e-maili i firmës ose i personit të autorizuar nga firma për kontakt

Për marrjen e Dokumentacionit të tenderit, ofertuesi i interesuar obligohet që të paguajë mjete të pakthyeshme në vlerë prej 100 euro në kundërvlerë të denarit sipas kursit të këmbimit të BPRM ditën e pagesës. Pagesa duhet të kryhet në dobi të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor,

Me shenjën: për marrjen e dokumentacionit të tenderit për ndarjen e koncesionit për ujë për prodhimin e energjisë elektrike nga 37 hidrocentrale të vogla

Për kompanitë e vendit:

Llogaria e thesarit: 100000000063095

Llogaria e shfrytëzuesit të buxhetit: 121011520278710

Shifra e të ardhurave dhe programi: 725939-40

Deponent: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë

Numri tatimor: 4030998358508

Për kompanitë e huaja :

Ministry of Environment and Physical Planning

National Bank of the Republic of Macedonia

Bu. GoceDelcev No.8
1 000 Skopje, Republic of Macedonia
SWIFT BIC: NBRM MK 2X
IBAN: MK07 1007 0100 0017 436

9. Gjatë përzgjedhjes së ofertës më të volitshme ekonomike do të shqyrtohen vetëm ofertat të cilat posedojnë dokumentacionin e plotë në pajtim me Instrukcionet për ofertues të cilat janë pjesë përbërëse e dokumentacionit të tenderit.

10. Kriteri për përzgjedhjen e ofertës më të volitshme ekonomike do të llogaritet sipas formulës:

$C = 12500 \times P_i + U$ (me shkronja: C është e barabartë me dymbëdhjetë mijë e pesëqind e shumëzuar me P_i plus U)

ku:

C –kriteri i rangimit

P_i –fuqia minimale e instaluar e hircentralit në kW e cila duhet të jetë e instaluar sipas ofertës së ofertuesit dhe që është theksuar në deklaratën e ofertuesit

- Nëse bëhet fjalë për grup lokacionesh P_i do të jetë shuma e fuqive të instaluara nga të gjithë lokacionet në grup

U –shtesë e ofruar e kompenzimit minimal të njëhershëm në denarë të Maqedonisë

11. Do të shqyrtohen vetëm ofertat e dorëzuara në arkivin e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor më së voni deri më 19 maj 2016 deri në ora 10:00 sipas kohës evropiane qendrore.

12. Ofertat dorëzohen në një ekzemplarë origjinal. Më tej, Oferta për lokacionin të dorëzohet edhe në pajisje elektronike transmetuese.

13. Hapja publike e ofertave do të jetë më 19 maj 2016 në ora 11 . Hapja publike do të bëhet me leximin e Zarfi 1, Dokumentacioni i obligueshëm dhe nëse dokumentacioni i obligueshëm është i kompletuar do të lexohet edhe Zarfi 2, Oferta për lokacionin, përkatësisht Letra për ofertë. Për hapjen publike Komisioni harton procesverbalë.

14. Koncesioni për shfrytëzimin e ujit do të jepet për periudhën prej 23 viteve në pajtim me Ligjin e ujërave dhe Ligjin për koncesione dhe

partneritet publik-privat. Obligimet e koncesionarit pas nënshkrimit të Kontratës për koncesion janë këto:

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për hidrocentralin për të cilën jepet Oferta
- Sigurimi i të gjitha lejeve dhe përmbushja e kushteve të definuara në lejet përkatëse në pajtim me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë;
- Ndërtimi i objekteve në pajtim me dokumentacionin projektues;
- Sigurimi i lejeve të domosdoshme për punën e hidrocentralit, në pajtim me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë;
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e të gjitha objekteve në kuadër të centralit;
- Bartja e të gjitha objekteve të hidrocentralit të vogël dhe tokës ku gjinden të njëjtat pas skadimit të periudhës së koncesionit, të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, nën kushtet dhe gjendjen e përcaktuar në kontratën për koncesion.

Për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë Shpallje publike investuesit e interesuar mund ti drejtohen personit të autorizuar për kontakt: Melita Goçevska e-mail: melitagocevska@yahoo.com dhe Ismail Luma e-mail: ismail.luma@economy.gov.mk

Tel: +389 2 3251420 Faksi: +389 251403

Për informata më të hollësishme në lidhje me lokacionet për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla vizitoni faqen: www.moep.gov.mk, shpp.moep.gov.mk.

15. Mbrojtja ligjore

Secili ofertues ka të drejtë ankimimi në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit për zgjedhjen e ofertës më të volitshme, përkatësisht në afat prej 15 ditësh nga dita e dërgimit të vendimit për anulimin e procedurës. Ankesa duhet të depozitohet te Komisioni Shtetërorë për ankesa për furnizime publike, e cila vendos për ankesën sipas dispozitave të Ligjit për furnizime publike.

Komisioni për zbatimin e procedurës për ndarjen
e koncesionit